



Pranuar / Dërguar Përmirëso/Prodato Received/Delivered	29-12-2023	3 viti god year	
Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTHCK	7759/2023		1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1347/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Rushit Kajtazi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional,në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1277/2023 të datës 12.10.2023 të parashtruar nga ankuesia ankesën A.nr.1312/2023 të datës 20.10.2023 të parashtruar nga ankuesi ankesën A.nr.1341/2023 të datës 27.10.2023 të parashtruar nga ankuesi ankesën A.nr.1345/2023 të datës 27.10.2023 të parashtruar nga ankuesi dhe ankesën A.nr.1347/2023 të datës 30.10.2023 të parashtruar nga ankuesi të bashkuara sipas Vendimit me numër protokolli 7089/2023 të datës 23.11.2023 në një procedurë të vetme nën shenjen A.nr.1347/2023 datë 30.10.2023, kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I.Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1277/2023 e datës 12.10.2023 e parashtruar nga ankuesja ankesa me numër A.nr.1312/2023 e datës 20.10.2023 e parashtruar nga ankuesi ankesa A.nr.1341/2023 e datës 27.10.2023 e parashtruar nga ankuesi ankesa A.nr.1345/2023 e datës 27.10.2023 e parashtruar nga ankuesi dhe ankesa A.nr.1347/2023 e datë 30.10.2023 e parashtruar nga ankuesi të bashkuara sipas Vendimit me numër protokolli 7089/2023 të datës 23.11.2023 në një procedurë të vetme nën shenjen A.nr.1347/2023 të datës 30.10.2023.

II.Anulohet Vendimi Nr.1403/1 i datës 11.09.2023 i Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetëror, Njoftimi i datës 12.09.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, lidhur me shpalljen e kandidateve fitues si dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarrë

nga faza e verifikimit paraprak deri në publikimin e Njoftimit të datës 12.09.2023, ndërsa, çështja kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *ri-vendosje* në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

III. Obligohet Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi sikurse është përcaktuar si në pikën II të këtij dispozitivi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 05.05.2023, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit, respektivisht në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) ka publikuar Konkursin për grupin "*Specialist i Arsimit*" me numër reference RN00011613, gjegjësisht pozitën e punës "*Inspektor i Arsimit*" SIA- Ferizaj, tri (3) pozita, ku afati i aplikimit ishte nga data 26.05.2023 deri më datë 05.06.2023. Si rrjedhojë nga shkresat e lëndës rezultoi se në këtë konkurs kanë aplikuar edhe kandidatët

(në tekstin e mëtejshëm: Ankuesit) por që të njëjtit nuk kanë arritur të jenë në mesin e kandidatëve fitues të cilët janë rekomanduar për emërim në Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesit, me datë 12.10.2023, 20.10.2023, 27.10.2023 dhe 30.10.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit është përcjell me shkelje të dispozitave ligjore.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas kërkesës së anëtarëve të Kolegjit të Këshillit, dhe me qëllim të ekonomizimit të procedurës, me datë 23.11.2023 ka nxjerr Vendimin me numër protokoll 7089/2023 me të cilin ka bashkuar procedurën për shqyrtimin e ankesave, A.nr.1277/2023 e datës 12.10.2023 e parashtruar nga ankuesja ankesën A.nr.1312/2023 e datës 20.10.2023 e parashtruar nga ankuesi ankesën A.nr.1341/2023 e datës 27.10.2023 e parashtruar nga ankuesi ankesa A.nr.1345/2023 e datës 27.10.2023 e parashtruar nga ankuesi dhe ankesën A.nr.1347/2023 të datës 30.10.2023 e parashtruar nga ankuesi të cilat sipas Vendimit me numër protokoll 7089/2023 të datës 23.11.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë bashkuar në ankesën e fundit me numër A.nr.1347/2023 të datës 30.10.2023.

Për shkak të kompleksitetit të ankesave, më datë 08.12.2023 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerr Vendimin me numër protokoll 7380/2023 përmes të cilit ka shtyrë afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune, të ankesave të bashkuara në ankesën A.nr.1343/2023 të datës 27.10.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e trajtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova, që janë relevante dhe ndërlidhen me vendimmarrjen (në tekstin e mëtejshëm: Kolegji i Këshillit) ankesën A.nr.1277/2023 e datës 12.10.2023 e parashtruar nga ankuesja ankesën A.nr.1312/2023 e datës 20.10.2023 e parashtruar nga ankuesi ankesën A.nr.1341/2023 e datës 27.10.2023 e parashtruar nga ankuesi ankesa

A.nr.1345/2023 e datës 27.10.2023 e parashtruar nga ankuesi dhe ankesën
A.nr.1347/2023 të datës 30.10.2023 e parashtruar nga ankuesi Konkursin për grupin
"Specialist i Arsimit" me numër reference RN00011613, pozitën "Inspektor i Arsimit" SIA-Ferizaj;
Vendimin Nr.1403/1 të datës 11.09.2023 të Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës
Shtetërore, Njoftimin e datës 12.09.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik,
lidhur me shpalljen e kandidateve fitues; Dosjen e kandidatëve fitues; E-mailin e datës 17.11.2023
të Zyrtareve përgjegjës të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës
31.10.2023, 01.11.2023, 06.11.2023, 07.11.2023 dhe 17.11.2023 , si dhe dokumentacionin tjetër
përcjellës mbi procedurën e zhvilluar.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët
në procedurë, konstatoi se ankesa është e bazuar dhe se lënda ku ankuesit janë palë në procedurë,
duhet të kthehet në **ri-shqyrtim dhe rivendosje** tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve
Publikë, sepse:

Kolegji i Këshillit, në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, ndërlidhur me plotësimin
e kërkesave të përgjithshme formale të konkursit, nga kandidatët në procedurë, ka analizuar
Konkursin me numër të referencës: RN00011613 për grupin "Specialistë të Arsimit", klasa e pozitës,
Profesional 1, pozita e punës "Inspektor i Arsimit" në SIA- Ferizaj, dhe si rrjedhojë ka gjetur se
kërkesa të përgjithshme formale, të përcaktuara në konkursin përkatës, kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në fusha: Arsim i Lartë i paspecifikuar;*
- *Licencë e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës;*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës me theks të veçantë përvojë pune në mësimdhënie.*

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit duke ju referuar shkresave të lëndës, gjegjësisht Njoftimit të datës
12.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në DMZP/MPB, ka gjetur se
tre (3) kandidatë fitues, me më se shumti pikë, për grupin "Specialistë të Arsimit" pozita "Inspektor
i Arsimit në SIA- Ferizaj", janë: 1. me gjithsejtë 83.6 pikë, 2.
me gjithsejtë 82.4 pikë, dhe 3. me gjithsejtë 81.8 pikë.

Kolegji i Këshillit, në kuadër të autorizimeve kushtetuese dhe ligjore lidhur me sigurimin e
respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, si dhe në kuptim të
shqyrtimit të pretendimeve ankimore analizoi dosjen e tre (3) kandidateve fitues të cilët kanë
mbledhur më se shumti pikë dhe rrjedhimisht janë rekomanduar për emërim në shërbimin civil,
dhe si rrjedhojë konstatoi se: 1. Kandidatja me rastin e aplikimit ka
dorëzuar diplomën me numër protokoll 129 datë 22.02.2009 me që rast kishte marrë titullin
Bachelor i Inxhinierisë Kompjuterike, e cila ka diplomuar me datë 05.07.2006, Diplomë me numër
me numër protokoll Nr.87/45-65, ka të përfunduar në Kolegjin UBT, Masterin e Shkencave
Kompjuterike dhe Inxhinieri; Diplomë me numër protokoll 054/16, datë 29.01.2018, të lëshuar nga
Universiteti i Tetovës-Fakulteti i Shkencave Matematiko- Natyrore, me që rast kishte mbaruar
Fakultetin e shkencave matematiko-natyrore, drejtimi informatikë , sipas Vendimit me numër
protokoll Ref nr. 6-184, të datës 10.05.2018 të lëshuar nga Kryesuesi i Këshillit Shtetërore për
Njohje, nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, i njihet grada "Profesor i
Diplomuar i Informatikës", licencën e mësimdhënësit nr.100024599 e lëshuar nga Ministria e



Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me datë të lëshimit 17.07.2017, data e skadimit 17.07.2022, si dhe me rastin e aplikimit ka dorëzuar edhe vërtetim të përvojës së punës, pasqyr të llogarisë në trust, diplom të shkollës së mesme, disa çertifikata të ndryshme që lidhen me çështje të trajnimeve të ndryshme, formularë të hospitimit në orën mësimore, certifikatë mbi dënimet penale, si dhe disa prova tjera por që nuk janë me relevancë në lidhje me këtë vendimmarrje andaj edhe nuk i kemi specifikuar më specifikishtë. 2. Kandidatja - me rastin e aplikimit ka dorëzuar Diplomën me Nr.545 të datës 12.09.2005 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës përmes të cilës vërtetohet se më datë 27.05.2005 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin e Shkencave Matematike - Natyrore, Dega e Kimisë, duke fituar kështu titullin "Profesor i Kimisë" si dhe Diplomën me Nr.180 të datës 22 gushtë 2011 të lëshuar po ashtu nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, drejtimi Kimi Organike dhe Biokimi, duke fituar kështu titullin Master i Shkencave të Kimisë. Po ashtu, me rastin e aplikimit e njëjta ka dorëzuar Licencën e Mësimdhënësit të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me afat vlefshmërie nga data 26.12.2012 deri më datë 26.12.2017, me rastin e aplikimit ka dorëzuar edhe diplomën e shkollës së mesme, disa dëftesa të viteve shkollore nga viti i parë deri në vitin e katër, vërtetime të përvojës së punës, vendim për emërim trajnere e programit kualifikues për orientim në karrierë, në nivelin IV, në Qendrën e Kompetencës në Prizren, çertifikata të ndryshme të trajnimeve profesionale, referenca, disa mostra të vlerësimit të performancës, vërtetim se nuk ka ndonjë masë disiplinore, pasqyrë të llogarisë në Trust, certifikatë mbi dënimet penale, si dhe disa dokumente tjera por që nuk kanë ndonjë ndikim sa i përket kësaj vendimmarrje, andaj edhe nuk i kemi specifikuar hollësisht 3. Kandidati tjetër fitues, me rastin e aplikimit ka dorëzuar diplomën me numër protokollit 1812 të datës 31.05.2010 me që rastë ka përfunduar Fakultetin e Filologjisë -Dega e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe dhe ka marr titullin *Profesor*, sipas diplomës me numër protokollit 133 të datës 21.06.2013, ka përfunduar Masterin në Shkencat Filologjike, dega e Letërsisë Shqipe, me rastin e aplikimit ka dorëzuar edhe diplomën e shkollës së mesme, disa dëftesa të viteve shkollore nga viti i parë deri në vitin e katër, vërtetime të përvojës së punës, kontrata për shërbime, kontrata mbi vepër, kontratë pune, certifikata/vërtetime të ndryshme të trajnimeve profesionale, pasqyra të llogarisë në Trust, referenca, disa mostra të vlerësimit të performancës, vërtetim se nuk ka ndonjë masë disiplinore, certifikatë mbi dënimet penale, licencën e mësimdhënësit e lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me datë të lëshimit 10.12.2012, data e skadimit 10.12.2017, mirënjohje, si dhe disa dokumente tjera por që nuk u specifikuan hollësisht nga se nuk janë me relevancë sa i përket kësaj vendimmarrje.

Nga analizimi i dosjes se kandidatëve fitues rezulton se kandidatët fitues, respektivisht kandidatja kandidatja dhe kandidati dhe kandidati me rastin e aplikimit kanë dorëzuar Licencë të mësimdhënësit të kualifikuar, me afat të skaduar.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me lëndët tjera që janë trajtuar në këshill ka marrë për bazë shkresën që është dërguar me qëllim të sqarimit të rrethanave juridike të krijuara si më lartë e që ndërlidhën me vlefshmërinë e licencave të mësimdhënësve që ju ka skaduar afati e të cilët janë përfshirë në listën e ngushtë dhe rrjedhimisht kanë vazhduar me fazat e mëtejme të rekrutimit, me që rast ka kërkuar informatë zyrtare nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, se mbi cilën bazë juridike janë vlerësuar këto licenca, ndërsa kjo e fundit, më datë 05.12.2023 ka njoftuar se: *Lidhur me pyetjen tuaj se si kemi bërë vlerësimin e licencave të mësimdhënësve të cilëve ju ka skaduar afati, a ka ndonjë dokument nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si ministri përgjegjës për lëshimin e licencave lidhur me këtë çështje, ju informojmë se Departamenti për Menaxhimin Zyrtarëve Publik, duke u bazuar në paragrafin 6 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it me nr.14/2023,*

për sistemin e licencave dhe karrierës i cili përcakton: "Licencat e karrierës se mësimdhënësve të lëshuara nga vitet 2012-2022, vazhdojnë për 5 vite. Këto licenca mbeten të vlefshme deri në realizimin e procesit të brendshme të VPM". Andaj Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik ka pranuar të gjitha licencat e mësimdhënësve gjatë verifikimit. Andaj, me qellim të vërtetimit të këtij fakti, më datë 17.11.2023 nga zyrtarët e këshillit është kërkuar informatë zyrtare nga përfaqësuesit e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës nëse Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr.14/2023 për Sistemin e Licencimit dhe Karrierën në Mësimdhënie është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa kjo e fundit të njëjtën ditë ka konfirmuar se "Udhëzimi Administrativ në fjale nuk gjendet i publikuar në ueb portalin e Gazetës Zyrtare, gjithashtu të gjitha aktet të cilat vijnë për publikim në portalin e Gazetës Zyrtare zakonisht publikohen brenda ditës".

Andaj, duke marr parasysh faktin se Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr.14/2023 për Sistemin e Licencimit dhe Karrierën në Mësimdhënie nuk është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit vlerëson se i njëjti nuk mund të prodhojë pasoja juridike. Për me tepër, edhe sikur të ishte i publikuar, i njëjti për shkak të mënyrës se si është nxjerrjes (gjatë fazës se zhvillimit të procedurës se rekrutimit) nuk do të mund të aplikohet në rrethanat e rastit konkret, ngase do të krijonte situatë diskriminuese në raport me gjithë kandidatët tjerë të cilët kanë poseduar licencë të mësimdhënësit të kualifikuar, me afat të skaduar, dhe nuk kanë aplikuar apo kanë aplikuar dhe ju ka refuzuar aplikacioni, për shkak të kriterit të konkursit, ngase në shpallje të konkursit decidivisht është kërkuar "Licenca e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës".

Prandaj, duke marr për bazë dispozitat e nenit 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (e aplikueshme në kohën e zhvillimit të procedurës përkatëse të rekrutimit), ku përcaktohet se: "Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërliken me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë", duke qenë se tani më është vërtetuar mjaftueshëm se janë përfshirë në listë të ngushtë, dhe për me tepër janë shpallur fitues edhe kandidatët të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret formale, sikurse është rasti me kandidaten fituese kandidaten fituese dhe kandidatin fitues të cilët nuk e posedojnë Licencë të mësimdhënësit të kualifikuar, të vlefshme. Kolegji i Këshillit konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, si njësi përgjegjëse, ka vepruar në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe si rrjedhojë në kundërshtim me dispozitat e nenit 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke mos respektuar kështu kriteret formale të përcaktuar në konkurs nga vetë organi përkatës që ka zhvilluar procedurën e rekrutimit, dhe për pasojë ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 34 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht, nisur nga qëndrimet e dhëna si me lartë rezulton se akti i goditur me ankesë, gjegjësisht Vendimi Nr. 1403/1 i datës 11.09.2023 i Komisionit të Pranimin në Institucionet e Administratës Shtetërore, si dhe Njoftimi i datës 12.09.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, lidhur me kandidatet fitues për grupin "Specialist i Arsimit" me numër reference

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1347/2023, datë 29/12/2023.

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve;
- Sekretares së Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë - MPB;
- Arkivit të KPMSHCK-së.